

PËRDORIMI I KAZANIT TË MBETURINAVE



Nëse disponohet, shtypni shkurt butonin (rrethi i kuq), për të ndezur impiantin. Nëse treguesi ndriçon verdhë, impianti është gati.



Mbajeni transponderin (çipin) para fushës së transponderit. Treguesi i gjelbër ndriçon dhe pusët janë të shkyçura.



Tani mund t'i hapni të dyja pusët dhe të asgjësoni mbetjet tuaja.



Pas mbylljes së pusit impianti kyçet automatikisht.

Ju nuk keni nevojë të bëni asgjë më tepër.



Sugjerim:

Përdorni ndarjen më të vogël, e cila i nxë mbeturinat tuaja. Në këtë mënyrë ju nuk do të ngarkoheni me kosto të panevojshme.

Indicație:

O autorizare prin intermediul transponderului este posibilă numai la câmpurile de transponder. Câmpurile de afişare servesc numai pentru semnalizarea stărilor de operare.



Fusha e transponderit



Fusha e treguesëve

Kushte të veçanta operative (Shenja e kuqe)

5x sinjal në ngjyrë të kuqe:

Transponderi juaj NUK është i lejueshëm.

Sinjal i kuq i vazhdueshëm:

Në boks nuk ka mbajtëse mbeturinash (apo gjëndje servisi).

Ndriçim i kuq i vazhdueshëm:

Mbajtësja e mbeturinave është e mbushur plot.



PËR TË LEHTËSUAR KURSIMIT E TË HOLLAVE DHE MBROJTJEN E MJEDISIT:

- Pranë kazanit të mbeturinave të mos vendoset asnjë mbeturinë
- Në enët për lëndë të riciklueshme të mos hidhen mbeturina të tjera
- Kalimi në njësi më të mëdha paketimi
- Të përdoren paketime me shumë përdorime dhe rimbushje
- Shportë për blerje në vend të qeseve plastike
- Të copëtohen kartonat e mëdhenj

Përse nevojitet kazan i mbeturinave?

Me qëllim që të renditet hedhja e mbeturinave të tjera shtëpisë suaj, dhe që ju të paguani vetëm pjesën tuaj (përfshirë një sasi minimale).

Kur regjistrohet hedhja ime?

Sapo që ju të keni hapur një ndarje mbeturinash.

Cila sasi përfshihet tek unë?

Përherë përfshihet kapaciteti i plotë i ndarjes së hapur, prandaj mundësisht shfrytëzoheni atë në mënyrë optimale.

Mbeturinat e mia nuk i nxë ndajra e mbeturinave?

Ne ju këshillojmë, të përdorni qese plehrash, të cilat e shfrytëzojnë në mënyrë optimale ndarjen e mbeturinave. Sende të cilat pengojnë bëjnë pjesë në mbeturinat e rënda, ose copëtoheni ato përpara hedhjes.

Çfarë ndodh nëse mbajtësja e mbeturinave brënda në kazan është e mbushur plot?

Treguesi jep sinjal të vazhdueshëm në ngjyrë të kuqe (pas hapjes). Deri sa të zbrazet nga asgjësuesi nuk mund të hidhen në të mbeturina të tjera.

Unë e kam humbur transponderin tim?

Luteni t'i drejtoheni menjëherë administratorit tuaj të shtëpisë, me qëllim që kërkuar të mos hedhë mbeturina me shpenzimet tuaja.

Unë nuk kam fare mbeturina?

Çdo shtëpie ka mbeturina të tjera, të cilat do të asgjësohen sipas rregullores përkatëse të vendit të tyre.

PËRSE NJË LLOGARI SHPENZIMESH E LIDHUR ME SHKAKTUESIN?

Mbeturina të tjera: Hedhja e mbeturinave të tjera është e shtrenjtë dhe ndoshta me tarifa në rritje.

Lëndë të riciklueshme: Hedhja e paketimeve plastike dhe metalike (si psh. shishet e lëngjeve, e kupat e kosit, kanaçet ...), letrat dhe qelqi janë falas. Mbasi: Çmimi i blerjes të produkteve me të tilla paketime përmban edhe shpenzimet për asgjësim dhe në këtë mënyrë ato janë paguar tashmë nga ju!

Qëllimi ynë: Të kursehen të hollat!

Si?

Reduktim i mbeturinave të tjera dhe ndarja e saktë e mbeturinave!

E rëndësishmet: Të gjitha mbeturinat, të cilat nuk bëjnë pjesë në mbajtëset e mbeturinave të tjera me pagesë të detyruar, hidhini në ato mbajtëse të lëndëve të riciklueshme (në kazana të verdhë/eventualisht në kazana ngjyrë portokalli, thasë të verdhë, mbajtëse letrash, kontenierë qelqi, mbledhëse rrobash të vjetra, e kështu me rradhë). **Këtu duhet të keni kujdes udhëzimin për ndarjen e mbeturinave.**

Kujdes: Në rast se mbajtëset e lëndëve të riciklueshme do të jenë bërë shumë pis si rezultat i hedhjes gabim i mbeturinave të tjera, atëherë e gjithë mbajtësja do të asgjësohet me çmim të mbeturinave të tjera. Kjo rrit në mënyrë të panevojshme shpenzimet për të gjithë!

